



Npi – 01/241 datë: 07.07.2025

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 07.07.2025, është nxjerrë:

E K S T R A K T P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -VII- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 07.07.2025 (e hënë), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu, z.Gëzim Haxhiu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Rrahman Jakupi, z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorat, z.Grejtalb Emini – DPUKGJ, z.Bardhyl Rushiti – DSHP, z.Besnik Ahmeti – DBF, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi – DSHMS, z.Valon Januzi- DPP, z.Imri Hoxha - DAP, z.Gojart Bajrami- DBPZHR, znj.Anita Kurti Shefe e Kabinetit të Kryetarit, znj.Gentiana Mehmeti, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit, z.Muhamet Hoxha - RZSH. Praktikantet, znj.Hava Llugaxhiu, znj.Agnesa Ademaj, dhe znj.Anesa Gashi. Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.06.2025,
2. Raporti i përgjithshëm gjashtë mujor i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes
3. Informatë nga KKSB për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2025,
4. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rrahman Jakupi: Ne e kemi rendin e ditës dhe meqenëse rendi i ditës përmban vetëm katër pika, atëherë propozojmë që Raporti i auditorit për vitin 2024 të jetë njëra prej pikave të rendit të ditës, për arsye se mendoj se para se të folet për një raport 6 mujor të këtij viti, mendoj se duhet të diskutojmë për një raport që është bërë nga zyra e auditimit të përgjithshëm dhe aty diskutojmë dhe shohim gjetjet e auditorit, arritjet dhe mendoj që është e rëndësishme që si dokument sot të debatohet, sepse për këtë çështje është diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar, mirëpo po e shoh që ekzekutivi e ka paraparë që sot ne mos të diskutojmë për këtë pikë, kështu që propozojmë që ky raport të futet si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Atëherë ne e kemi një pikë të propozuar mirëpo edhe raportit të auditimit do ti vije radha sepse çdo pikë e ka kohën e saj.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 6 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstënim”, miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.06.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 16 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 2 vota “Abstënim”, miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 27.06.2025.**

Pika 2

Raporti i përgjithshëm gjashtë mujor i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, fjalën ja dha Kryetarit, z.Qemajl Aliut, për prezantimin e raportit.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Të nderuar asambleistë, gjithë ju të pranishëm, të nderuar qytetarë, të nderuar drejtorë, kolegë të ekzekutivit kamë kënaqësinë që sot para jush të prezantojë punën 6 mujore të Ekzekutivit të Komunës së Shtimes. Siç e dimë Buxheti i Komunës së Shtimes është 10,778,454 euro, duke shtuar edhe mjetet e bartura dikund rreth 11 mijë euro, ku realizimi i Buxhetit deri para dy jave ka arritur në 40.91%. Siç e dini zotimi më i madh i kësaj qeverisje ka qenë dislokimi i Entit Special, ku së bashku me Kryeministrin z.Albin Kurti dhe me Ministrin z.Arben Vitija, dhe së bashku me qytetarët e kemi hedhur gurëthemelin për ndërtimin e objektit të ri të Entit Special. Ky projekt është mirëpritë shumë mirë nga qytetarët, kështu që ky projekt ka filluar të bëhet realitet. Projekti ka një vlerë prej 6.3 milion euro faza e parë dhe pritet që në të ardhmen ti bashkangjitet edhe faza e dytë, ku projekti do të arrijë shumën diku në total rreth 12 milion euro. Një projekt tjetër me një rëndësi shumë të madhe është edhe ndërtimi i objektit të ri të QKMF-së, ku edhe për këtë projekt para dy jave e kemi hedhur gurëthemelin e këtij objekti. Kësaj i shtojmë edhe renovimin edhe të dy QMF-ve në Komunën e Shtimes. Një prej projekteve më të mira e më të qëlluara është ndërtimi i Unazës së Madhe ku së bashku me Ministrin z.Liburn Aliu, kemi filluar ndërtimin, dhe atje po punohet me një dinamikë të madhe me një vlerë prej mbi 1.5 milion euro. Tjetër projekt është ndërtimi i objektit të ri të Komunës me vlerë prej 2.4 milion euro ku do të jetë shtëpia e qytetarëve të Komunës së Shtimes. Po ashtu ndërtimi i tribunave të Stadiumit të qytetit prej 2.4 milion euro, i cili është në fazën përfundimtare. Pastaj edhe renovimi i Qendrës Rinore veçse është në përfundim. Në vazhdim Kryetari prezantoi edhe projektet e tjera të punës 6 mujore të ekzekutivit (shih dokumentin).

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha znj.Adelina Beqaj.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje për të gjithë. Realisht me e pa një televizor këtu në Kuvend duket më shumë si një film se si disa projekte të cilat i ka realizu ky Kryetar qe katër vite mandat. E përmendi një buxhet marramendës edhe qe katër vjet qitash ja ka nis me i bë disa punime. E përmendi Entin Special, gjë që ke pas shumë ankesa prej qytetarëve dhe kjo gjë nuk të ka interesu hiq, pastaj QKMF-në që do të bësh investime milionshe gjë të cilat i ke dëmtu bizneset në Komunën e Shtimes në atë pjesë, edhe qytetarët e Komunës respektivisht pacientët që do të marrin shërbim në periferi të Komunës, e palogjikshme është. Po ashtu e përmende edhe sheshin, Kryetar ki me mbyllë biznese dhe nuk ke ba asnjë alternativ për bizneset të cilat do të kryejnë veprimtarin. Mandej objekti i Komunës prapë në periferi, je ka don me zhvendos krejt qendren në Çest të Reçakut çëkjo është esenca jote. Prej fushatës ke fillu me përmend renovimin e Qendres Rinore, pjesën e vrazhdë e ke pas të përfundume, thjesht ke pas nevojë me i bë disa renovime edhe me lënë një rojtar aty. Edhe qysh është e mundur Kryetar Çerdhes së vjetër me i thënë Çerdhe e re, ku veq i ke bërë disa lyrje me polikollor aty, pastaj shkollën në Petrovë ke thënë me bë shkollë të re ke shtu aneks po ashtu në Vojnovc as nuk ja ke fillu shkollës. Ti Kryetar shkolla te reja nuk ke mundur me promovu, thjeshtë ke promovuar disa paisje laboratorike. Te rruga “Mehdi Korrani”

në Petrovë ke thënë që i lidhë të gjitha rrugët e fshatit Petrovë, jo Kryetar ke mungesë të informacioneve Petrova është një fshat shumë i madh aty nuk i lidhë të gjitha lagjet, është hapë një rrugë alternative e cila ka qenë e mirëpritur sepse vetë e kam propozuar në drejtorin e DPUKGj-së dhe jeni mburrur me këto sene. Më bëri përshtypje që e paske gjetur një kanalizim te pishat sepse mbi 80% e territorit të Komunës ka qenë e përfunduar me kanalizim, ju kanë mbetur disa rrugica të vogla private. I përmende rregullimin e trotuareve po si po qëndron puna për mirëmbajtjen e tyre ti po paguan kompani ekstra si ajo “Xhema” e cila e mirëmban ambientin e Komunës së Shtimes mirëpo nuk po shoh trotuare të mirëmbajtura. E përmende që familjarët e Dëshmorëve i ke dërgu në deti pse nuk e përmende që e ke dërgu në deti edhe ekzekutivin Kryetar ka qenë një shumë e madhe. Po ashtu e përmende asfaltimin në fshatin Davidovc mirëpo çfarë ka ndodhur me mbikalimin në fshatin Davidovc dhe Belinc e ke premtuar gjatë fushatës mirëpo nuk është realizuar. Edhe për fund një pyetje direkte për këto projekte, a i ke kalkuluar mirë milionat sepse mua po më duket që më shumë keni përfituar se sa që keni përruruar, kalkuloj mirë sepse po më duket që këtu ka punë edhe prokuroria, ju faleminderit.

z.Rrahman Jakupi: Ne kemi pranuar një raport 6 mujor të Ekzekutivit dhe të njëjtën kohë e patëm një prezantim nga Kryetari për çka mendoj që më shumë është një shou edhe përshkrim i detyrave të punës së Ekzekutivit. Është mirë që po bëhen projekte në Komunën e Shtimes, kanë ndodhur edhe paraprakisht, mirëpo e pashë që këto projekte kanë ardhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Për ne nuk është shqetësuese shtruarja e asfaltëve por është shqetësuese blerja e votës përmes shtruarjes së asfaltëve. Siç e kamë përmend edhe në mbledhjen e kaluar ka nevojë për një hetim të mirë për shtrimin e asfaltëve në zona private. U përmendën shumë çështje, sa për tju hedhur pluhur syve qytetarëve sepse shumica prej këtyre projekte veq se kanë ekzistuar. Qe 4 vite po e përmendi një treg, çfarë është duke ndodhur me atë treg mendoj që aty ka keqpërdorim. U fol për çështjen e kapitaleve mirëpo nuk u folë se si është gjendja e qytetarëve. Është shqetësuese Zona Ekonomike ku asnjë biznes nuk është i vendosur aty.

Objekti i Komunës është i filluar pa plan me shkarkim të menaxheres dhe shumë me rëndësi është me ditë se si janë bërë pagesat në fillim të këtij objekti. Nuk u fol sot fare për gjendjen në shëndetësi dhe arsim, për keqpërdorimin dhe nepotizmin. U përmenden milionat nuk e di deri sa shkonë shuma, Kryetari i Komunës ja ka hupë Shtimes 300 milion euro duke e refuzuar një biznesmen nga Gjermania i cili ka pas me ndërtu një park solar atje tek Enti Special.

Unazë nuk është me lidhë Davidovcin me Lagje të Pajtimit. U përmendën disa rrugë të cilat kanë qenë të pa asfaltuara sepse kanë qenë votues të PDK-së përmes të cilave po mundoheni me ba pazar për blerjen e votave. Sot në Emërgjenc nuk punon aparati i klimatizimit, mjekët edhe pacientat që shkojnë aty kanë telashe. Ju e keni dërgu në prokurori themelore shtrimin e rrugës “Devetak” ndërsa tani po e shtroni atë rrugë është hipokrizi. Nëse ju nuk e kishi pas Qeverin e Republikës së Kosovës asnjë projekt nuk kishi mujtë me realizu.

z.Asllan Beqaj: Përsëritet, faleminderit Kryetarë për raportin, një raport që i ka mungu Komunës së Shtimes për vite të tëra. Sa i përket filmit që u tha, është e vertetë duhet me u bë dy filma njëri duhet me qenë për Kryetarin dhe investimet që i ka bërë dhe tjetri duhet me qenë film i rekordeve të bllokimit të projekteve nga opozita në Kuvendin e Komunës së Shtimes. Kjo opozitë në këto 3 vite e gjysmë nuk e di fare a ka përkrahë ndonjë projekt. Investime ka pasur në tërë Komunën e Shtimes dhe nuk ka pas ndamje në asnjë segment, po ashtu te asnjë qytetarë. Kur flitet për asfaltimin e rrugicave e rrugëve, janë duke u asfaltuar plotë rrugë siç është rasti në Petrovë, Davidovc, Rashincë etj. Kryetari harroj me e cekë edhe rregullimin e shtratit të lumit në Petrovë që më herët askush nuk është marrë me të, e që ka qenë shumë problem për qytetarët

e Petrovës. Nëse flasim për arsim është kampion i investimeve në shkollë, në Petrovë shkollë ka qenë në gjendje të mjerueshme ndërsa tash është duke u rregulluar shumë mirë. Po flasim për Petrovën pasi që është fshati më i madh e jo që janë lënë anash fshatrat tjerë. Investimet e kanë arritur vlerën në 7 milion euro e që investime më të mëdha nuk ka pasur kurrë në Petrovë. Përveç investimeve po i përmendi edhe bllokimet, duke ja filluar prej Çerdhes në Godanc që nese ishin miratuar në Kuvend me kohë tash ishim duke i përruruar dy çerdhe njëkohsishtë në Shtator, pastaj projektin e sheshit herën e kalume u munduat ta bllokoni.

Sa i përket largimit të Komunës, qytetet të cilat kanë vizion, shkojnë vetëm duke u zgjeruar.

Ndërsa sa i përket shëndetësis nuk ka pasur investime më të mëdha asnjëher duke filluar nga funksionalizimi i të gjitha QMF-ve, në Komunën tonë, pastaj edhe ndërtimin e QKMF-së, po ashtu investime ka edhe në arsim. Thuhet mbi 95% e kërkesave të qytetarëve janë realizuar.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshendetje, duke pasur parasysh që unë jam anëtare e Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” dhe i gjithë procesi kalon përmes neve si anëtarë të Komisionit, mirëpo kur bëhet fjalë për ndarjen e çmimit, pse ne nuk jemi të ftuar, një ish anëtar i të LDK-së i është nda ky çmim dhe ne si anëtarë nuk kemi qenë të ftuar që të paktën të jemi prezent në ceremoni, këtë pyetje ta kamë bërë edhe heren e kaluar mirëpo nuk e kamë marrë përgjigjen.

z.Muhamet Ademaj: E falënderoj Kryetarin për raportin 6 mujor, ky raport përfshin realizimin e projekteve në arsim, infrastrukturë, shëndësi, bujqësi, ekonomi. Unë jamë i kënaqur me punën dhe menaxhimin e Kryetarit mirëpo nuk jamë i kënaqur me punën e disa drejtorëve. Unë si anëtarë i Kuvendit i kamë disa shqetësime për disa projekte kapitale që nuk janë realizuar, trotuari në rrugën “Hyrë Emini” që nga viti 2021 nuk është përfunduar ende, ka qenë në projekt edhe asfaltimi i aneksit të rrugës “Kruja”, pastaj rruga “Mihajl Grameno” në Davidovc ka qenë në projekt nuk është realizu, nuk ka filluar ndërtimi i kanalizimit në lagjen “Roboj” mos zgjidhja e problemit të ujit të shkollës “Bajram Curri” në Petrovë dhe asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Petrovë janë bërë disa dallime kështu që nuk janë të pranuar për neve.

z.Përparim Ramusa: Përshendetje, prezantimi i raportit nuk është një pasqyrë e punëve po ke një propagand që ta paraqes para qytetarëve. Kryetari e ka premtu që mbrenda këtyre viteve do ta funksionalizoj QKMF-në tash e ka fillu. Unë e kam një pyetje ku ka logjikë që QKMF-ja të ndërtohet në periferi të qytetit? po ashtu le të më tregon Kryetari cili qytet e zhvendos Komunën nga qendra në periferi? Qe 3 vite e ka përmend një treg të qytetit dhe ende nuk e ka përfunduar. Edhe një pyetje dua ta bëj mirëpo Kryetari le ti shikon në sy qytetarët dhe le të ju jep përgjigje qysh pas 4 vite i ka ra ndërmend për varrezat e dëshmorëve. E përmende që do ta bësh një projekt për parkun e qytetit dmth. ende nuk e keni bërë. E kamë një pyetje konkrete për Kryetarin e ka pas premtu investim në ujësjellës aka arritë që brenda këtyre 4 viteve 1 litër ujë me ja shtu qytetarëve të Komunës së Shtimes. Sa i përket Çerdhes së Petrovës unë jamë ai që e kam votuar mirëpo pa dituria e ekzekutivit e ka shtyer procedurën.

znj.Zejnije Veliu: Përshendetje, e falënderoj Kryetarin Aliu për raportin 6 mujor, duke pasur parasysh që buxheti i Komunës është 10,778,454 euro, duke shtuar edhe mjetet e bartura, dikund 11 mijë euro është bërë shpenzimi i tij deri në 40.61% brenda këtij 6 mujori. Siç i dimë zotimet e Kryetarit janë të shumta si, Enti Special, ndërtimi i objektit të Komunës, investimet dhe renovimet në arsim, investimet në infrastrukturë, ndarja e subvencioneve për nënat lehona etj. Duhet të cekim që Shtimja po rritet dhe ashtu siç e ka rritjen e ka edhe zhvillimin dhe ata që e bëjnë planin e zhvillimit e dinë që zhvillimi duhet të bëhet në periferi. Shtimja është kthyer në një kantier ndërtimi dhe po punohet në të katër anët.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje, unë realisht të falenderoj shumë Kryetarin për gjithë atë raport për punët e mira që janë bërë në Komunën e Shtimes. Po du me i përmend edhe disa projekte të cilat duhet me i ditë kolegët asambleist e që janë për herë të parë si psh. trajtimi mamografis në QKMF, po ashtu duhet të cekim se Kryetari qysh në vitin 2021 ka thënë se do ta gjejmë një hapësirë në Komunën e Shtimes për zhvendosjen e Entit e jo që do ta heqë nga Komuna e Shtimes, dhe dua të jua dëshmoj përmes një video atë që e ka thënë Kryetari. Siç e thashë duhet shumë kohë për të përmendur të gjitha projektet mirëpo duhet të besohet se po bëhen punë të jashtëzakonshme.

z.Kadri Emini: Përshëndetje, ne sot para vetes e kemi një raport 6 mujor të cilin e elaboroj Kryetari i Komunës sipas detyrës zyrtare. Normalisht çdo projekt që bëhet është në interes të qytetarëve ne ju gëzohemi, besoj që edhe çdo qytetarë i gëzohet. Deshta me i shtrë dy çështje jashtëzakonisht të rëndësishme. E para është problematik monitorimi i punëve në teren, e merreni si rekomandim që të monitorohen punët në Kuvend nga drejtoritë përkatëse dhe e dyta duhet të japim maksimumin që të mos kemi ndasi për shkak të bindjeve politike ose fetare ose kombëtare për realizimin e projekteve. Unë i kam pasur disa kërkesa e të cilat janë jetike për tu realizuar e që besoj që në ditët në vijim duhet të realizohen. Si grup parlamentar jemi që ky raport të kalojë Kryetar të lutem merri seriozisht këto dy çështje që i paraqita.

znj.Saniye Sadiki: Përshëndetje, unë e kam një pyetje për Kryetarin, Kryetar me këtë ritëm të punëve, a po na duhet me shpikë projekte të reja në mandatin tjetër sepse gjithçka po kryhet në afat rekord, unë e kuptoj opozitën sepse me bërë krahasimin e 20 viteve në pozitë me 4 vite është shok për ta.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje, ndëgjova shumë parafolës për këtë raport 6 mujor. Projektet kanë ndodhë por nuk krenohemi me ato që kanë ndodhë. Por Kryetar unë mendoj që duhet të ndalemi te projektet e zotimeve që janë shumë jetike, në fushatë ke premtuar që do të përfundojnë të gjitha projektet e ujësjellësit dhe kanalizimit kjo nuk po ndodhë, apo e sheh Kryetar që këto projekte janë më jetike sesa projektet e ndriçimit dhe trotuareve. Këtu nuk është vendi as për me bërë cirkuze e as filma por është vendi me tregu realitetin, mirëpo realiteti është diçka ndryshe. Unë kam këtu disa kontrata ku projektet nuk janë të specifikuara, pse nuk janë specifiku? Kryetar ti u krenove për mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve mirëpo unë di varreza që janë pa lapidar. Kryetar unë kam drejtorë të shkollave të cilët janë ankuar që nuk kanë printer ndërsa ti po thu që kanë. Mua më ka ardhur një shkresë nga një qytetarë mirëpo për shkak të minutazhës do ta lexoj Adelina sepse edhe asaj ja ka përmendur emrin.

znj.Adelina Beqaj: Atëherë unë e kam një pyetje për Kryetarin po i referohem asaj pyetje që e ka bërë qytetarja: Qyteti ynë ka potencial për të promovuar artin bashkohorë në nivel mbarë kombëtar dhe ndërkombëtar siç potencon ekspozita në Shtime me çmimin prestigjioz “William Voker” megjithatë vërejmë mungesë të reagimit institucional dhe promovim të kësaj ngjarje të rëndësishme nga ana e Komunës, një ekspozitë që nderon qytetin dhe në një kontekst më të gjerë mbetet po thuajse në heshtje ndërsa promovimi i aktiviteteve lokale si kori i qytetit zhvillohet në mbështetje të dukshme dhe pa vonesa. Në këtë kontekst a mundeni të na sqaroni si i shihen prioritetet kulturore, a konsideroni që kori ka më shumë rëndësi se sa një ngjarje që e vendos qytetin tonë dhe Komunën në hartën e artit bashkohorë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke pasur parasysh që mbështetja financiare për këtë ekspozitë ka ardhur me vonesë dhe në një shumë simbolike 499 euro, a është kjo politikë kulturore që do të vazhdoni në mandatin tuaj, cili është vizioni juaj për artin bashkohorë dhe qfarë masa planifikoni për të mbështetur artistet vendor që e përfaqësojnë Komunën dhe vendin me dinjitet jashtë vendit, një qytetare që beson në dinjitetin dhe rëndësinë e artit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pasi që kjo ka të bëjë më znj. Beqaj dhe po i lexon komentet e qytetarëve, unë tu kisha lutë me hy në faqe të Komunës e ki me emër dhe mbiemër, kështu që për mua është shumë shqetësuese që Adelina a je ti qajo që ke ardhë dhe më ke thënë që ta nali socialin, dmth. qytetarja ka thënë se ti i ke kërcënuar me ndalje të socialit nëse nuk ta japin votën

për asamble dhe ajo ka dalë me emër publikisht, jepja sqarimin pra unë nuk po ja përmendi emrin, sepse ka shumë raste këso, mirëpo njëra paska marrë guximin për me dalë publikisht.

znj. Adelina Beqaj: Unë ju përgjigjem këtij facebook fake, këto janë propaganda të vetëvendosjes për shkak të mungesës së argumenteve për me mu kundërvu mua më shpifin kësi gjëra. Nëse gjatë punës time në Entin Social kamë bërë shkelje ligjore atëherë ju kishi qenë të parët që mu kishit kundërvu, gjatë kohës së fushatës unë kam qenë shtatëzën dhe një muaj nuk kamë qenë aty mirëpo në pushim siç e kërkojnë rregullat, këtë mund ta dëshmojë. Sa i përket votave kamë kërkuar vota prej më të varfurit deri tek milioneri. Pyetja juaj Kryesues ke me qëllim ndërsa e imja vetëm çfarë ka pyetur një qytetare, nuk mundesh mua me më akuzu për kësi gjëra koti që ty të konvenojnë për fushatë.

z. Gëzim Haxhiu: Përshëndetje, unë si asambleistë i pavarur e vlersojë përkushtimin e Kryetarit të Komunës në realizimin e projekteve publike, mendoj që paraqesin një hap pozitiv drejtë zhvillimit të Komunës sonë dhe si përfaqësues i qytetarëve është detyrë e imja me i përkrahë punët e mira edhe siç thotë një fjalë e urtë popullore inatin ja paq hakin nuk bënë me ja hangër.

z. Lumni Amrushi: Përshëndetje, Kryesues tu kisha lutë mos ta banalizojm Kuvendin por të flasim për punë konkrete të cilat nuk po shihen. Janë disa fake lajme dhe nëse duhet me bërë një film të tretë atëherë duhet me bërë një film të propagandës, të rrenave, të komenteve që ju për rrjete sociale jeni kampion. Mirëpo shumë shpejtë janë zgjedhjet dhe qytetari do të ju vlersoj. E përgëzojë Kadriun që tha më herët se mungesa e kuadrove po e bënë që mos të realizohen projektet mirë, mirëpo Kadri këtu nuk është mungesë e kuadrove këta specifikisht i caktojnë menaxherat e kontratave ata të cilët ju konvenojnë këtyre. Sa i përket disa projekteve u përmend Gllavica që u lë anash, nuk ka fshatë që nuk është investuar më herët. Disa punë të mira janë bërë ju përgëzojë mirpo në mungesë të profesionalizimit ja keni huqë.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Vetëm një sqarim kjo ke me tregu që këtu nuk jemi me lexu komente por jemi këtu me fol për materialin që ju ka ardhë.

z. Besnik Seferi: Mu po më vjen keq që po krijohet njëfarë debati jashtë rendit të ditës, kështu që tu kisha lutë ty Kryesues mos të dalësh jashtë kontekstit për çka edhe jemi thirrur këtu. E dyta Kryesues është që nuk po mundem të ju bijë në fije sinqerisht po e them, nga disa parafolës të opozitës u tha që nuk është bërë sen, ndërsa tash del tjetri dhe thotë gjithë ata miliona ato pare qysh po doni me i qu kur nuk keni njerëz eksperta. Mirëpo qytetarët duhet me ditë që çdo punë e mirë i ka prekë qytetarët e Shtimes pa dallim e mandej edhe këta i ka prekë, prandaj duhet me u krenu të nderuar koleg sepse edhe politika e ka një lloj njerzillëku.

z. Asllan Beqaj: Më duhet patjetër me e marrë fjalë sepse kur po përmendet bllokada është e vërtetë që e keni blloku, edhe kur po foli që i keni harru disa fshatëra është e vërtetë prapë që i keni harru vetëm shkoni në dëgjime publike dhe e shihni. Në Gllavicë vetë qytetarët thojnë që na kanë lënë anash unë spo e them vetë këta e thonë, mirëpo i kamë dëgjuar qytetarët duke e thënë. Edhe tjetra nëse ju kishi lënë edhe rrugë kryesore pa asfaltu atëherë nuk e di qfarë qeverie kishi qenë. Edhe po më vjen marre për ju opoziten kur thoni se nuk keni blloku ju keni bllokuar edhe mirë bile në fillim kur i ka prezantu Kryetari projektet ju thonit këto projekte nuk kanë me u bërë kurrë por kur fillojshin me u bërë ju dilshit të parët për me i blloku këto projekte. Nuk është marre me thënë para qytetarëve që ne jemi bllokues të këtij vendi se nuk kemi qef me parë qeverisje që punon për këta qytetarë.

z. Rrahman Jakupi: Opozita këtë punë e ka, vetë keni me shku në opozitë dhe keni me pa. Çështja e dytë llaptopat që janë duke u vjedhur prej zyrtarëve të Komunës raportet në polici që ekzistojnë, ka mungesë të mjeteve higjienike, mungesë të printerve nëpër shkolla, kabinetet të cilat ne i kemi lënë nuk po mund të mirëmbahen. Këtu unë e pranova një kërkesë të një qytetari për një trotuar në Belinc ende nuk është rregulluar. Ne jemi këtu për me i pranë kërkesat e qytetarëve.

z. Asllan Beqaj: Deri pak më herët opozita tha kur spo keni argumente po kapeni privatisht, e çka bani ky zotria tani. Nese keni argumente për këto që i përmende pse nuk po i përmendeni mirëpo po kthehesh në sende të kota. Unë nuk e kam gruan drejtoresh të Çerdhes as nuk e kam pasur kurrë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pas tërheqjes 3 herë të vërejtjes anëtarit të Kuvendit z.Rahman Jakupit në bazë të nenit 9.1.1 të Regullores së Punës së Kuvendit i shqiptohet masa e ndalimit të diskutimit të mëtutjeshëm.

z.Përparim Ramusa: Një gjë që e ndëgjova prej Besnikut dhe më pëlqeu është se ne këtu duhet me pas njërzillëk. E jo Kryesues me i shti drejtorat ose dikend tjetër me kriju llogari fallc dhe me komentu, për një nënë dhe zonjë që është këtu e që shihet që është fallc ajo llogari. Nuk është njërzillëk me thënë se nuk ka punu për asnjë fshat. Po e marr shembull Gllavicën a është bërë mjaftueshëm jo, a po bëhet edhe sot kur ju jeni jo, sepse ka kërkesa edhe më të mira e më të arsyeshme që qytetarët i bëjnë. Në qeverisjen paraprake në Gllavicë është ndërtuar shkolla, është shtruar asfalt, është futur sistemi i ujësjellsit në gjithë fshatin, është punuar për një pjesë të madhe për kanalizim mirëpo nuk është përfunduar sepse nuk mund që për një mandat ose dy me u përfundu të gjitha edhe ju kur ta leni do të ketë punë të pa përfunduara.

z.Kadri Emini: Singerisht për mu është e pa pranueshme keqpërdorimi mikrofonit prej shumicës së anëtarëve. Unë lusë që secili qytetarë apo anëtarë i Kuvendit që ka fakte për keqpërdorim të detyrës zyrtare ti adresojnë në vendet adekuate në këtë rast tek prokuroria. Të gjithë e dinë që unë kamë raporte shumë të mira me Kryesuesin, mirëpo Kryesues unë mendoj që është gabim me u lexu një koment nga facebook këtu në Kuvend. Ne jemi sot këtu për me u votu një raport i punës 6 mujore të ekzekutivit, kjo është çështja që duhet me u diskutu në këtë sallë të Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: z.Emini çështja e komentit veç e sqarova njëherë po e sqaroj prapë, dëshira ime ishte që me tregu në këtë Kuvend që s'kemi nevojë me u marrë me komente prej jashtit sepse ne e kemi rendin e ditës, kjo ke pra e që nuk kishte nevojë që me lexu komente prej jashtë sepse mundem edhe unë. Këtu jemi me diskutu për rendin e ditës dhe me votu.

z. Rexhep Gashi: Është shqetësuese nga diskutimet që po bëhen si nga ana e drejtorëve po ashtu edhe anëtarëve. Kryesues nuk ishte një koment por një çështje që është tek raporti që ju ka nda një shumë prej 499 euro këtyne që kanë apliku si OJQ, këtu e kanë ngritur shqetësimin se a është një shumë simbolike dhe a kemi mundur me e nda një shumë më të madhe. Kjo nuk është një koment por një shkresë që e ka paraqitur një qytetarë.

znj.Albana Podvorica: E kamë një kërkesë për ty Kryesues që me mbajtë rendin e ditës më mirë. Kisha dashtë me repliku me Kryetarin kur tha që të gjitha shkollat janë të pajisura me kabinete mirëpo ka ende shkolla që nuk janë të pajisura me kabinete dhe uroj që në të ardhmen të pajisen. U folë për renovim të shkollave mirëpo nuk u folë për mirëmbajtjen e tyre ku shumë shkolla nuk kanë makina për prejen e barit. Dhe deshta me e përmendë ndriçimin te parku i pishave ku nuk ka ende ndriçim.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Pas një pune 6 mujore së bashku me Ekzekutivin dhe me Administratën e Komunës e që janë orë të gjata e të plota pune në teren, pra kemi njerëz këtu që mundohen me bastardu këtë raport. Po e shihni se jo vetem ato 100 e ca zotime që janë në GAP por janë edhe 100 e më shumë projekte që janë duke u implementu në teren, kështu që të jeni të bindur që jemi edhe krenarë edhe ballë hapur për punët e mira që po bëhen duke ju falënderuar për mundësinë që na e keni dhënë me i bë këto ndryshime për secilin prej jush. Këtu krahasimi është 21 vjetë me 4 vjetë. Desha ti përmend vetëm sa për ti bërë disa krahasime të vogla, dikush tha qe ju e keni qu administratën në deti, të dashur qytetarë urdhëroni e shikoni se si qeverisja e kaluar i ka dërguar punëtorët në Shqipëri për shetitje me shumë prej 3.600 euro, ndërsa ne i kemi dërguar për trajnim. Ne e kemi bërë një kërkesë, ku tani tokat e pylltarisë ju kanë kthyer Komunës, dhe atje në atë zonë faktikisht po ndërtohet qyteti i ri, ndërsa ju me vendim të juajin parkut të qytetit ja keni hequr statutin e pronës publike dhe e keni kthyer në pronë private. Po ashtu qeverisja e juaj e ka hequr autostradën nga Shtimja dhe e ka dërguar në Malishevë dmth për 15 vite qeverisje jo vetëm që nuk i keni sjellur asgjë komunës së Shtimes por edhe ja keni hequr autostradën që është dashur të kaloj nëpër Shtime. Ju jeni ata që i keni privatizu tokat dhe tani nuk kishte vend për ndërtimin e Komunës së re. Unë e kamë premtuar ndërtimin e QKMF-së së re, e jo spital qysh po e thuani ju. Për fund i falënderoj të gjithë asambleistët që i kanë përkrahë këto projekte, po ashtu edhe secilin drejtor e anëtarë të kabinetit tim. (2:20)

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ: Përsëritet për të gjithë, me ua thënë të drejtën, nuk e kam pas ndërmend me fol sot fare, mirëpo u diskutua shumë për portale (fake) për rrjetin e facebookut, unë personalisht jamë atakuar nga portalet (fake) e që për mua nuk është problem sepse jamë person publik, 24 orë me qëndru në portale (fake) nuk prishë punë, por është ataku edhe familja ime, pastaj është ataku edhe një shefe e kabinetit të Kryetarit, e këtu janë prekë në moral, është keqpërdor edhe foto e gruas time, edhe ka dalë në një portal, e kanë pa e gjithë Shtimja, asnjë reagim prej grave as prej grupit të grave të PDK-së, në këtë rast nuk ka pas. Shtrohet pyetja, a i keni edhe ju dyshimet e njëta qysh i kamë edhe unë se mbrenda grupit të juaj ekziston grupi administrues i "Shtime on" dhe "Kosova opinion" nëse i keni dyshimet e njëta, atëherë duhet me qenë hipokrit për mos me pranë, se e gjithë Shtimja e din jo zyrtarish se ka dyshime se kush qëndron mbrapa këtyre portaleve, unë i kamë ndjekë hapat ligjor, në fakt gruaja ime, ajo nuk është person publik nuk punon në asnjë institucion publik, unë nuk e kamë problem nese dikush bën kallxim penal, është e drejtë ligjore, zhvillohen procedurat krejt në rregull, as raportet njerëzore nuk i prishë, mirëpo me u fshehtë mbrapa portaleve të tilla një subjekt politik nuk është në rregull, kjo është një gjë që ka ndodhur. Ku e din ky zotria që gruaja ime e ka dërguar rastin në polici, pastaj ku e din a e kanë marrë në pyetje policia. Siç kanë thënë ish Ministri i shëndetësis në fëtyrat e juaja shihet, dhe e dini se kush administron me portalet e tilla.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Më duhet të flasë për dy çështje që i harroj Kryetari, se u bë një pyetje që në Komunën e Shtimes po ka probleme për staf, është e vërtetë që në Komunën e Shtimes po punohet shumë dhe sinjerisht ka problem me staf se me këtë staf nuk është e mjaftueshme me i mbulu të gjitha këto projekte që po zhvillohen e që vetëm tani janë mbi 50 projekte që janë duke u realizu në Komunën e Shtimës. Por një fakt i asaj që më shqetëson është dokument zyrtarë me vulë në qeverisjen e PDK-së në vitin 2018 paguhen 10 mijë euro, për trajnim 5 ditë për 5 punëtorë të Komunës së Shtimes në bregdetin Shqiptarë, dhe unë po dua me u kundërpërgjigj në atë që u tha se Komuna e Shtimës nuk ka staf, pra Komuna e Shtimes nuk ka asnjë programer, këta emra të cilët janë trajnu me 10 mijë euro në bregdetin Shqiptar në vitin 2018, dhe nga qeverisja e PDK-së nuk figurojnë askund e as nuk dihet se kush ishte programer në Shtime, e sidomos brenda institucionit të Komunës së Shtimes. Pika e parë flasim për qeverisjen e Kryetarit Aliu dhe qeverisja e partisë Demokratike, shpenzimet për dreka zyrtare qeverisja e PDK-së 2017-2021 70.833 euro, dreka zyrtare dhe dallimi është 40 mijë euro mbrenda një mandati, shpenzimet e telefonit, mandati i kaluar dhe mandati i tashëm, diferenca është 20.750 euro. Komplet Administrata dmth. 33.49 euro, qeverisja e partisë Demokratike i ka shpenzime të telefonit për një mandat. Ish Kryetari i ka harxhuar 1.590 euro telefoni roming për një muajtë këto janë dokumenta. Ish Kryesuesi 2013-2017 i ka 290 euro shpenzime telefoni. Qytetarë të nderuar do ti publikoj të gjitha këto dokumenta, edhe kisha pas dëshirë qata 5 programera që i dini që i keni qu në deti me i sjellë se po na duhen në Komunë. Nëse bëjmë një dallim të çmimit Buxheti i Komunës së Shtimës ka qenë 8 milion afërsisht, sot është 12 milion nëse bëjmë krahasimin e shpenzimeve të atëhershme dhe investimet e sotshme atëherë i bjen që i kanë shpenzu 100% më shumë se kjo qeverisje unë po flasë për këtë raport dhe po e përmbylli këto janë dokumenta zyrtare me vulë, se po thonë se janë propaganda. Në fund po e qes raportin në votim meqenëse janë shterrë diskutimet. Prezent në sallë i kemi 18 anëtarë të Kuvendit.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 10 vota "Për", me 7 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" miratoi, Raportin gjashtë mujor të punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për vitin 2025.**

Pika 3

Informatë nga KKSB për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë. Këtë pikë nuk kemi pse ta hudhim në votim sepse është informatë, dhe nuk votohet. Kështu që nëse nuk ka diskutime atëherë kalojmë te pika tjetër e radhës pyetje-përgjigje.

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Albana Podvorica: Te informata e KKS-së për 6 mujorin e parë Janar- Qershor 2025, po më intereson me ditë për nxënësit që janë me initiale a e kanë vijë shkollimin? Ndërsa tjetra pyetje është, një kërkesë e kamë për Policinë e Komunës së Shtimes ku kërkoj që Policia ti rrisë patrullat më shumë në sigurim për shkak se kemi shqetësime nga të rinjtë që po vozisin motorra dhe trotineta elektrik gjë që po e vështirsojnë komunikacionin. E kamë edhe një pyetje, pasi që u fol për diskriminime e në këtë rast në mes partive kisha dashtë me ditë nga drejtoria përkatëse, për ndriçimin në rrugën “Lutfi Bilalli” ku njëri drejtor më ka thënë që ka me formu një komision për me dalë dhe me shiku se qysh po qëndron puna, vetëm kjo lagje nuk ka ndriçim deri ku keni shku me hapa?

z.Rrahman Jakupi: Përse Administrata Komunale e në këtë rast Kryetari nuk përgjigjet në pyetjet që unë i bëjë. Pyetjet kanë pasur të bëjnë me disa vepra penale që janë duke u zhvilluar në Drejtorin e Shëndetësisë, Urbanizëm, Kulturë, Arsimit dhe në të gjitha drejtoritë që janë të përfshira në vepër penale? Pyetja tjetër a paguan Kryetar njerëz ose më konkretisht OJQ-ë në mënyrë të kundërligjshme e që njerëzit e tillë punojnë për ato organizata e që tash janë duke u hetuar për vepra penale? Po ashtu Kryetar sa projekte janë duke u hetuar nga njësia për hetimin e krimeve ekonomike në total? Pse nuk keni leju me diskutu për ujësjellësin e fshatit Rashincë këtu në Kuvend dhe pastaj e akuzoni opozitën që nuk i ka përkrahë projektet? Përveç këtyre pyetjeve i kamë edhe pyetjet e mbledhjes së kaluar ku ekziston procesverbali dhe nuk kamë marrë përgjigje. Dhe pyetja tjetër e kamë bërë një kërkesë për çasje në dokumente zyrtare për kontratën e AZHR-së dhe për atë e kamë pranuar vetëm një dokument që nuk tregon asgjë. Dhe kisha dashtë me ditë për një zyrtarë Albion Shabani, cila është forma konkrete e angazhimit të tij në Komunë cili është titulli zyrtarë që ai mbanë?

z.Gëzim Haxhiu: E kam një kërkesë për DPUKGJ-në, disa banorë të rrugës “Fejzullahu” në fshatin Vojnovc e kanë një kërkesë për vendosjen e disa pengesave në këtë rrugë për shkak se ka ankesa se aty po zhvillohet shpejtësi e madhe?

z.Besnik Seferi: E kamë një pyetje për PDK-në e më konkretisht për Rrahman Jakupin, nëse jo ti atëher kush nga anëtarët e Kryesisë së juaj është duke e menaxhu këtë portal, sepse këtu po flitet për pazarin që unë e kamë bërë e po ashtu po flitet për lajmin se unë jamë sponzor me z.Aliun dhe me z.Eminin si dhe z.Ademaj? Po e them një fjalë popullore e që nuk duhet me e thënë që “fort po na e mbani qirin” e që po u tregoj të drejtën, se fort keni me na rritë.

z.Rrahman Jakupi: Është hera e 3 ose 4 që po diskutohet për këtë çështje, ju inkurajoj juve që nëse keni argumente konkrete qoftë për mu qoftë për ndonjë anëtarë të PDK-së të gjitha këto shqetësime që ju po i përcillni për lajmet (fake) ti adresoni në prokurori themelore apo speciale. Unë përgjigjem në çfarë do forme. Ne si subjekt politik nuk kemi kohë me u marrë me lajme (fake).

Nënkryetari, z.Faruk Beqa: Për nxënësin që pati një pyetje ne i kemi marrë disa masa, e që përveç tjerash është vendosë që ai duhet me vazhdu mësimin, pastaj prindërit duhet me e përcjellë në shkollë dhe me e marrë prej shkollës. Ndërsa për pyetjen tjetër unë kamë informata në KKS nga Komandanti i Stacionit Policor ku është hartu një plan i veprimit, me të cilin janë marrë masat për ata që vozisin shpejt motorra e trotineta elektrik e që besoj i keni pa veprimet e Policisë edhe në fshatra e kështu me radhë. Po ashtu në një numër të aktiviteteve që i kemi në planin e veprimit praktikisht po i realizojmë dmth. përmes projekteve që i realizon drejtoria përkatëse. Ne nuk kemi pas nevojë për një buxhet të veçantë sepse i kemi realizuar përmes aktiviteteve që i kanë zhvilluar drejtoritë përkatëse komunale.


z.Grejtalb Emini, DPUKGJ: Veç me e sçaru që asnjë moment nuk e kamë përfshi PDK-në si bartës të portaleve (fake) vetëm se ka dyshime që dikush nga ju i administron këto portale (fake) e për këtë arsye kisha pas dëshirë me e ditë se a e dini edhe ju apo jo?

Kryetari, z.Qemajl Aliu: U bë një pyetje nga një asambleist i PDK-së e që është kandidat për Kryetar, e që u bë orvatje nga ana e tij për të dalë i pastër nga fakti që i kanë bllokuar projektet

në Kuvend. Kështu që i bëj thirrje për kërkimfalje për dëmin që i ka shkaktuar Komunës së Shtimes, duke i bllokuar projektet zhvillimore me papërgjegjësinë e vet, dhe mos me u fshehtë mbrapa emrit të Dëshmorëve. Dëshmorët e kanë vendin e tyre dhe nuk guxojnë me u keqpërdor. Respektin ndaj Dëshmorëve dhe ndaj familjarëve të tyre unë e kam dëshmuar në vepër me punë dhe angazhim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora: 13:13h.

Procesmbajtësi
Shqiprim Hyseni



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

